




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION




Emri i biznesit: Albatrade Music&Movie L.L.C.

Numri Unik Identifikues: 811293993

Personi i autorizuar: Florend SHALA

OSHMA:

1. EKRAN - FILM BUÇKO
2. EKRAN - FILM AUTOKTON
3. EKRAN - FILM APSOLUT
4. EKRAN - DOKU UNIVERS
5. EKRAN - FILM IKON
6. EKRAN - MUSICALB
7. EKRAN - MUSIC SUPER HITS dhe
8. EKRAN - NEWS



Adresa: Rr/Kushtrim Jashari p.n,
Prishtinë

VENDIM

për ndërprerjen e vendimeve për licencimin e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Adiovizuale: Ekran – Film Buçko, Ekran – Film Autokton, Ekran - Film Apsolut , Ekran - Doku Univers , Ekran – Film Ikon Ekran – Musicalb, Ekran – Music Super Hits, Ekran News, me transmetim përmes sistemit të operatorëve të shpërndarjes – me seli në Prishtinë

Faktet

1. Komisioni i Pavarur për Media (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audiovizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. Rregullorja për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale KPM-2017/02, ka hyrë në fuqi më 25 janar 2017, ndërsa, me Kreun III të kësaj rregulloreje, KPM ka krijuar bazën ligjore për licencimin e Ofruesve të Shërbimeve Audio dhe Audiovizuale të cilët transmetojnë përmes operatorëve të shpërndarjes, e që do të kenë mundësi të prodhojnë programe përmbajtjesore dhe t'i transmetojnë ato përmes cilit do operator të shpërndarjes.
3. Më datën 16 tetor 2019, kandidati “Albatrade Music&Movie L.L.C.”, ka parashtruar aplikacionet për licencë të KPM-së për Ekran – Film Buçko, Ekran – Film Autokton, Ekran - Film Apsolut , Ekran - Doku Univers , Ekran – Film Ikon Ekran – Musicalb,

Ekran – Music Super Hits, Ekran – Dok – Univers, Ekran News, për të vepruar si ofrues i shërbimeve mediale audiovizuale (OSHMA) me transmetim përmes sistemit të operatorit të shpërndarjes.

4. Më datën 26 dhjetor 2020, Komisioni ka marr vendim për licencimin e OSHMA-ve: Ekran – Film Buçko me numër të referencës 1911/1381/LIC/ni, Ekran – Film Autokton me numër të referencës 1911/1380/LIC/ni, Ekran - Film Apsolut me numër të referencës 1911/1379/LIC/ni, Ekran - Doku Univers me numër të referencës 1911/1378/LIC/ni, Ekran – Film Ikon me numër të referencës 1911/1382/LIC/ni, Ekran – Musicalb me numër të referencës 1911/1383/LIC/ni, Ekran – Music Super Hits me numër të referencës 1911/1384/LIC/ni dhe Ekran News me numër të referencës 1911/1385/LIC/ni, për të vepruar si ofrues të shërbimeve mediale audiovizuale (OSHMA) për transmetim përmes sistemit të operatorit të shpërndarjes, me afat të licencës prej dhjet (10) viteve.

Arsyetim

5. Komisioni konstaton se, fillimisht, kandidati “Albatrade Music&Movie L.L.C.” ka aplikuar për licencë të OSHMA-ve, për tetë (8) kanale, më datën 5 qershor 2019, mirëpo për shkak të mos kompletimit të dokumentacionit, edhe pas udhëzimeve nga KPM, Komisioni ka refuzuar kërkesat për licencë të “Albatrade Music&Movie L.L.C.” me vendimin e datës 24 korrik 2019.
6. Komisioni vlerëson se, Albatrade Music & Movie L.L.C. si bartës i licencave të KPM-së për tetë (8) OSHMA-të e cekura më lart, duke mos u pajisur me pakon e Licencës edhe pas udhëzimeve të KPM-së, nuk ka shprehur interesim për fillimin e aktiviteteve të transmetimit.
7. Pas përcjelljes së vendimeve për licencim të tetë (8) kanaleve të përmendura më lartë, Zyra Ekzekutive e KPM-së, me datën 10 janar 2020 dhe datën 7 shkurt 2020, përmes e-mail-i i ka përcjellë “Albatrade Music&Movie L.L.C.” dokumentin - Formatin e Programit dhe e ka udhëzuar për plotësim e tij në pajtim me skemat programore të dorëzuar me rastin e aplikimit për licencë. Gjithashtu, kandidati është kontaktuar përmes telefoni si dhe Departamenti i Licencimit ka zhvilluar edhe një takim ne Zyrën Ekzekutive të KPM-së për këtë qëllim, mirëpo i licencuari ka dështuar që ta dorëzojë dokumentin e plotësuar.
8. Me datën 22 tetor 2020, Zyra Ekzekutive e KPM-së i ka dërguar shkresë “Albatrade Music&Movie L.L.C.” me anë të së cilës e ka udhëzuar përfundimisht të licencuarin që brenda shtatë (7) ditëve të punës të dorëzojë dokumentin – Formatin e Programit të plotësuar në mënyrë që të përgatiten dhe të nënshkruhen pakot e licencës për OSHMA-të e cekura më lartë në këtë rekomandim, mirëpo prapë i licencuar ka dështuar të dorëzojë dokumentin e kërkuar.
9. Komisioni vlerëson se, i licencuari përfundimisht ka dështuar të veproj sipas udhëzimeve të KPM, duke mos u pajisur me Pakon e Licencës të KPM-së dhe se nuk ka shprehur interesim që të ushtroj aktivitetin e transmetimeve televizive përmes sistemit të operatorëve të shpërndarjes.

10. Komisioni, në takimën e tij të mbajtur më datën 13 nëntor 2020 që, merr vendim për ndërprerjen e vendimeve të licencimit për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audiovizuale me transmetim përmes sistemit të operatorëve të shpërndarjes në Republikën Kosovës: Ekran – Film Buçko - vendimi me numër të referencës 1911/1381/LIC/ni, Ekran – Film Autokton – vendimi me numër të referencës 1911/1380/LIC/ni, Ekran - Film Apsolut - vendimi me numër të referencës 1911/1379/LIC/ni, Ekran - Doku Univers – vendimi me numër të referencës 1911/1378/LIC/ni, Ekran – Film Ikon – vendimi me numër të referencës 1911/1382/LIC/ni, Ekran – Musicalb – vendimi me numër të referencës 1911/1383/LIC/ni, Ekran – Music Super Hits – vendimi me numër të referencës 1911/1384/LIC/ni, Ekran News – vendimi me numër të referencës 1911/1385/LIC/ni.
11. Obligimet financiare të të licencuarit “Albatrade Music&Movie L.L.C.” për këto tetë (8) kanale do të përmbushën në pajtim me Legjislacionin në fuqi.

E drejta për Ankesë

12. Ankesat i parashtrihen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së në pajtim me nenin 29, paragrafi 5, të Ligjit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkohen nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42, paragrafi 2, të Ligjit të KPM-së.
13. Bordi për Ankesa do t'i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërish të relevante të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.
14. Këtë vendim e lëshon Komisioni, dhe i njëjti hyn në fuqi nga data e nënshkrimit.



Xhevat LATIFI

Kryetar

Komisioni i Pavarur i Mediave



13.11.2020

datë